



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:266599

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747165

KPPP.nr. 2066/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Leaf Management” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810007030 dhe me seli në Magjistratën Ferizaj - Shkup, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Burhan Qosa dhe Labinota Qosa Ilazi, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “Hangover Club” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811586075 dhe me seli në Gjakovë, rr. “Gasper Karaqi”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 693/23 të datës 08.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Hangover Club” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 693/23 të datës 08.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Leaf Management” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 693/23 të datës 08.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve; Faturës nr. #7A, e datës 24.07.2023, duke detyruar debitorin “Hangover Club” Sh.P.K., që në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 5,000.00 EUR (me shkronja: pesë mijë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e arritjes për pagesë të faturës, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në shumë prej 156.00 €.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor asnjëherë nuk është nënshkruar nga ana e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor sipas propozimit për përmbartim të kreditorit është i pa bazuar, për çka gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta refuzojë si të pa bazuar.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje ndaj prapësimin ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke shtuar se debitori ka qenë i njoftuar për borxhin që rrjedh nga fatura e përshkruar në propozimin për përmbartim dhe i njëjti ka kërkuar një javë kohë shtesë për të përmbushur detyrimet e tij si dhe në rast të mos pagesës ka rekomanduar që të fillohet procedura përmbartimore. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 156.00 €, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet; Fatura nr. #7A, e datës 24.07.2023, në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se fatura e lartcekur, nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme i’ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilës Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2066/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.